



REPUBLICA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr.1 Datë 10 .01.2013

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT
TË ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ, NË ZBATIM
TË NENIT 18, PIKA 4/C TË LIGJIT NR. 9072, DATË 22.05.2003 “PËR
SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 18 pika 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 13, të Rregullores për Procedurat e Heqjes se nje License, miratuar me vendimin nr. 68, datë 04.11.2005, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e grupit te punes,

Vendosi :

1. Miratimin e Rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI